



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 5.1.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), Hajrullah Çeku (OJQ-Prizren), përfaqësuesi i ICO, media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 27.12.2011,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Projektligjit për qendrën historike të Prizrenit,
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua me votim formal pa ndryshime, pasi që paraprakisht kryetari i komisionit arsyetoi mbajtjen e mbledhjes urgjente sipas kërkesave nga Qeveria dhe nga Kuvendi i Kosovës.

**2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.12.2011**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.12.2011.

### 3. Shqyrtimi i projektligjeve sipas rendit të ditës

**Kryetari Nait Hasani** përshëndeti të pranishmit duke sqaruar për punën e deritashme të komisionit rreth projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe qendrën historike të Prizrenit. Ai tha se këto dy projekte dalin nga pakoja e Ahtisarit, ndaj propozoi që ato të trajtohen në këtë komision me një urgjencë më të madhe, ngase është kërkuar edhe nga Qeveria por edhe nga Kuvendi.

#### **Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe**

**Kryetari i Komisionit** përshëndeti përfaqësuesen e Këshillit trashëgimor të Kosovës zj. Gjejlane Hoxha, konstatoi se ky projektligj është trajtuar deri tani në komision dhe në grupin punues me një seriozitet mjaft të lartë ngase bëhet fjalë për vlera të përgjithshme të garantuara me Kushtetutë, mirëpo për shkak se duhet të kemi kujdese rreth mospërzierjes së fesë me politikë, kemi sugjeruar trajtimin përmes ekspertëve kompetent, në mënyrë që mos të përkufizohet ky fshat si trashëgimi nacionale serbe, por të jetë në shërbim të qytetarëve të Kosovës.

**Liburn Aliu** nuk u pajtua që këto dy projektligje të trajtohen me urgjencën e kërkuar ngase në të dy projektligjet kemi probleme të mëdha. Trashëgimia kulturore paraqet vlerën e përgjithshme botërore ndaj duhet të jemi tejet të kujdesshëm për shkak se urgjenca mund të sjellë gabime. Ky Projektligj, neni 9, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe karakterin e saj laik, ngase jap kishës autoritetin për tërë zonën e fshatit, derisa Kushtetuta shpallë Kosovën si shtet laik (shkelja e laicitetit të Kosovës si shtet). Brenda territorit të fshatit jetojnë ateistët, pjesëtarët e fesë islame, katolike etj. KZM si autoritet që propozohet për këtë fshat, është vetëm për trashëgimin serbe, ndërsa asaj i jepen edhe kompetenca rurale (neni 2). Ai tha se nga ministria përkatëse GP ka kërkuar listën e monumenteve historike, gjë që nuk është sjellë dmth nuk kemi listë të shpallur konkrete por kemi një zonë serbe që pretendohet të ligjësohet.

**Salih Morina** ishte i mendimit se për këto dy projektligje ka vërejtje të shumta, së pari është dashur të hartohet nga ministria kompetente e kulturës pa privilegje për ndonjë nacionalitet. Sa i përket urgjencës së kërkuar që të përfundohet me këto dy projekte deri më 23 janar, ai tha se është kohë tepër e shkurtë, ngase duhet të shqyrtohen përmes ekspertëve ashtu si është kërkuar në mbledhjen e fundit të komisionit. Këshilli për trashëgimi kulturore është anashkaluar, ndërsa komisioni i ka dhënë Qeverisë shansin për përmirësime, por ato nuk kanë ndodhur. Tani na mbetet që me një punë të përbashkët dhe maksimale të përmbledhim vërejtjet nga dy komunitat, të shqyrtojmë ato dhe disi të përmbylim me amendamente.

**Sevdije Lama** ishte e mendimit të epen së pari mendimet e ekspertëve ndërkombëtarë ngase urgjenca nuk kryen punë.

**Nijazi Idrizi** tha se mbledhja plenare ka miratuar këtë projektligj por ligji si i tillë nuk bënë të izolohet ngase fjala është për kulturë, ndaj duhet të shfrytëzohen drejtat për ankesa nga shoqëria në përgjithësi dhe të marrin ato rrugën e duhur përmes gjykatës më të lart në vend. Ai nuk kundërshtoi angazhimin e ekspertëve ndërkombëtar dhe bëri apel për maturi (mosngutje).

**Gjejlane Hoxha** shprehu kënaqësinë ngase komisioni ka kuptuar që duhet bërë modifikimin rrënjësor të projektligjit dhe propozoi që ky ndryshim të bëhet patjetër përmes ekspertëve ndërkombëtar. Dy shkaqe janë kryesore sipas saj : 1. dëshirojmë involvimin e politikave evropiane dhe 2. nuk disponojmë me ekspert të nivelit të duhur për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore. Përndryshe, vazhdoi ajo, me këto dy projektligje përfundimisht do të shkatërrojmë trashëgiminë tonë kulturore. Ajo insistoi për dy ekspertët e cekur në mbledhjen e fundit, të cilëve ju është drejtuar por ende nuk ka marr përgjigje për shkak të pushimeve, ngase ajo vet nuk do të mund të jap kontributin e duhur (për shkak të rregullave ndërkombëtare për planet e veçanta hapësinore, studimet paraprake, caktimi i kufijve, problemeve etj). Për fshatin Hoçë ajo tha se ka mjaft paqartësi, ndërsa për Prizrenin studimi ka përfunduar. Ajo gjithashtu u angazhua për mos azhurnim dhe parashitje pyetjen kush e ka sjellë këtë gjendje për shkatërrimin e trashëgimisë

sonë kulturore. **Kryetari i Komisionit** reagoi dhe tha se komisioni (politika) është ai që vendos për përgjegjësi dhe pyetje të tilla. Ajo tha se këtu ka punë efektive rreth një muaj, përfundimisht me dy muaj do të mund të japin mendimin përfundimtar rreth projektligjeve në fjalë, ngase kemi të bëjmë me shkellje të kushtetutës.

**Nait Hasani** tha se këshilli për trashëgimi ka pasur kohë nga shtatori 2011 të hartoi vërejtjet konkrete, vërejtjet që qojnë te kthimi i projektligjit nuk do të mund të kalojnë ngase ka kaluar në leximin e parë, ndaj sugjeroi që ekspertja prezentë të hartoj deri të martën vërejtjet konkrete : çka duhet të ndryshohet në 11 nenet e projektligjit.

Gjithashtu **Salih Morina** u pajtua që vërejtjet të përgatiten me shkrim deri në mbledhjen e radhës.

**Nijazi Idrizi** përsëriti se duhet të dëgjohen vërejtjet e shoqërisë civile të cilat është dashur të shqyrtohen me debat të madh publik nga ministria përkatëse, ngase tani ky komision është i pafuqishëm për gjithë këto punë, u angazhua për ekspertizë ndërkombëtare duke konstatuar se koha deri 23 janar është e shkurtër. Komisioni duhet të shqyrtoj këtë projekt ashtu si projektligjet tjera, sidomos këtë ngase ka shumë pakënaqësi.

**Liburn Aliu** theksoi pamundësinë absolute që deri 23 janar të përfundojë shqyrtimi për këto dy projektligje duke konstatuar që komisioni ose mund të toleroj këtë projektligj ashtu si është ose të punoj ashtu si duhet.

**Nait Hasani** përmbledhi vërejtjet kryesore për të cilat ekspertja prezent duhet të sugjeroj :

- neni 8 i Kushtetutës për shtetin laik,
- neni 4 i projektligjit për komitetin i cili duhet të jetë këshill,
- neni 3.3 që përcakton anëtarin e këshillit i cili mund të jetë banor i fshatit e jo ashtu si është propozuar,
- neni 5 ku duhet të caktohet autoriteti për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve (pika 5),
- neni 7 rreth aktivitetit të kufizuar të KZM për planifikim rural.

**Gjejlane Hoxha** përsëriti kërkesën për tre ekspert të cilët këshilli do ti kërkoj.

#### **Projektligji për qendrën historike të Prizrenit**

Sikurse për Hoçën ashtu edhe për këtë Projektligj **Kryetari i Komisionit** konstatoi situatën e ngjashme ngase ky projektligj është miratuar në leximin e parë. Për këtë projekt ai numëroi disa shkresa të arritura në komision, peticione, vërejtje, deklaratën e KK Prizren etj. Ai ftoi komisionin në trajtimin e këtij projektligji duke pasur parasysh çështjet e ndjeshme që u cekën rreth projektligjit për Hoçën : komiteti duhet të jetë këshill, të caktohet baza kushtetuese me ndryshimi i karakterit fetar të projektligjit. Për ndryshim nga projektligji për Hoçën, për këtë Projektligj kemi studimin e kryer çka mundëson më lehtë të amendamentohet Projektligji.

**Liburn Aliu** tha se Projektligji e shkelë Kushtetutën në tre aspekte : 1. është diskriminues pasi KZM-në e vendosë si autoritet mbi tërë zonën. 2. KZM ka kompetenca vetëm për trashëgimi kulturore e fetare serbe, derisa brenda kësaj zone kemi trashëgimi kulturore e fetare islame, katolike, kombëtare shqiptare etj. 3. është kundër barazisë fetare, pasi në KZM ka përfaqësues vetëm kisha ortodokse e ashtuquajtur serbe dhe rruga e vetme për ankesa nga palët është ajo në KZM, pra hoxha ose prifti katolik do ti shkruajnë ankesë priftit ortodoks kur nuk pajtohen për diçka. 4. është kundër laicitetit të shtetit pasi në Komitet kanë përfaqësuesit e vet të tria bashkësitë fetare dhe ato në njëfar mënyre kanë autoritet të vetos dhe mund ta dërgojnë çdo qështje në KZM. Duhet të formohet një ekip për shqyrtim profesional të Projektligjit, derisa 23 janari është tepër shkurt për ta shqyrtuar si duhet, komisioni duhet të ketë qartë çka po i dorëzon këshillit për shqyrtim, në mënyrë që ai të shqyrtoj atë çka ofron komisioni. Projektligjin mundemi ta ndryshojmë sa të duam, nëse ndryshohet 50% ai bien automatikisht sipas rregullores. Me këtë projektligj diskriminohen bashkësitë tjera fetare përveç asaj serbe, shkelet laiciteti i shtetit tonë. Të gjithë deputetët kanë përgjegjësin personale dhe do të ballafaqohemi me një turp të madh nëse miratojmë ligjin, KZM i cili duhet të zëvendësohet me një autoritet tjetër (cili autoritet) dhe prifti, edhe këtu do të kanë fjalën kryesore, ndaj kjo është pabarazi totale, kjo nuk mund të lejohet, përfundoi.

**Sevdije Lama** konstatoi se 70% i qytetit nuk mund të përfshihet me këtë ligj, komisioni duhet të shfrytëzoi mundësit që i ka për shqyrtim të një Projektligji : debatet, ekspertizat etj.

**Salih Morina** tha se komisioni në pavarësinë e tij nuk mund të ketë imponime, ndaj u angazhua për një datë të arsyeshme për të shqyrtuar këto dy projektligje.

**Afërdita Berisha** tha se ky komision gjithmonë u angazhua për ligje në favor të qytetarëve çka duhet të vlej edhe për këtë rast pa përjashtime, përndryshe komisioni jap fjalën e fundit.

**Nijazi Idrizi** konstatoi se këto vlera që po trajtohen i takojnë Kosovës, ndaj problemet duhet të shtjerrën me debate, konsensus në nivelet përkatëse, përballje me shoqërinë civile, grupi punues të trajtoj problemin me ekspert ndërkombëtar nga vendet që kanë probleme sikurse te ne që janë, duke hap rrugën e duhur të zgjedhjes së problemit.

**Liburn Aliu** potencoi faktin se përveç tjerave, këtu ka nevojë edhe për ekspert ligjor (jurist) i cili sugjeron si të zgjidhet ky problem, si menaxhohet trashëgimia etj.

**Nait Hasani** konstatoi se Qeveria ka kërkuar amendamentimin duke propozuar heqjen e nenit 18.4 (ky propozim nuk ka arritur zyrtarisht përmes zyrës së pranimi në Kuvend-stafi), si dhe vërejtjet tjera duhet të sqarohen me anë të këshillit dhe të hartohen vërejtjet konkrete, ngase rrugë tjetër nuk ka, Prizreni gjithsesi duhet të mbrohet por jo kështu duke mos ndërmarr asgjë.

Në vazhdim Kryetari i Komisionit ja dha fjalën përfaqësuesit të OJQ nga Prizreni, por për shkak të ofendimeve nga i njëjti, u ndërpre diskutimi i tij.

**Liburn Aliu** tha se heqja e pikës 18.4 nuk zgjedh problemin ngase neni 20 vazhdon ti ketë prapë ato probleme të ngjashme. KZM ka autoritet mbi krejt zonën, dmth ky ligj nuk ndryshohet nëse nuk i ndërrohet logjika që do të thotë se duhet të hiqet KZM. Ai shprehu pesimizmin se këshilli mund të bëjë diçka deri të martën, ngase këtu nevojitet ekspertiza ndërkombëtare.

**Gjejlane Hoxha** tha se këshilli nuk ka mandat për dhënien e ligjeve dhe njoftoi se ky këshillë funksionon vetëm me dy anëtarë të cilët nuk mund ta finalizojnë si duhet ngase nuk ka ekspert ligjor.

Komisioni nxori :

## **P Ë R F U N D I M**

**Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Projektligjit për qendrën historike të Prizrenit do të vazhdoi të martën më 10 janar 2012 kur do të shqyrtohen vërejtjet konkrete me shkrim nga Këshilli për trashëgimin kulturore.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,30.

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryetari i Komisionit,  
**Nait Hasani**